

Kërko

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



**1** Socialiste e orëve të para, ndahet nga jeta Eva Dura



**2** Kërkohej ndërkombëtarisht për trafik droge në Evropën Lindore, kapet shqiptari në Peru me 72 kg kokainë! Zbulohet skema, si futej droga me polumbarë në anije (Emri)



**3** Mandati i tretë i Edi Ramës dhuratë nga Sali Berisha dhe Ilir Meta, çështja e detit përballë një opozite të 'dalë mendsh'



arres

Aktualitet

## Tiranë- Ekzekutohet në makinë me 10 plumba ish-polici 26-vjeçar, mik i Ervis Martinajt (EMRI)

Një ish-polici është ekzekutuar me 10 plumba mbrëmjen e sotme në zonën e 'Xhamllikut'. Viktima është Santiago Malko, mik me Ervis Martinaj. Ngjarja ka ndodhur orës 22:20 minuta, ku policia ka identifikuar një nga autorët e dyshuar si dhe e ka shpallur atë në kërkim. Dyshohet se vrasja ka ardhur për motive hakmarrje, duke qenë se viktima është një emër i njohur si kontigjent kriminal.

- ☐ Identifikohet një nga autorët e dyshuar, vrasja dyshohet për hakmarrje
- ☐ Nëna shpërthen në britma e lot pak metra larg trupit të djalit
- ☐ Gjendet një makinë e djegur në Ferraj, dyshohet e autorëve
- ☐ Kush është ish-polici i vrarë, pronar i lokaleve të basteve dhe lidhja me vrasjen në bllok
- ☐ Santiago Malko në lokalin 'Monopol' në Bllok (VIDEO)

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com



**Redaksia**

27 Gusht 2019, 22:30 | Përditesimi i fundit: 28 Gusht 2019, 00:39

Share 53

Tweet

**A\*** **A****Nje det me oferta te pret...****zbulo me teper ne [booking.adriaferries.com](https://booking.adriaferries.com)**

**TIRANË-** Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Tiranë, ku në zonën e “Porcelanit”, është vrarë me armë zjarri një ish-efektiv policie. Santiago Malko, që dikur ka shërbyer në radhët e policisë së Shtetit dhe më pas i përjashtuar, është qëlluar për vdekje nga persona ende të paidentifikuar brenda në makinën e tij.

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com


Gazetari i Report Tv, Elton Qyno njofton se policia është vënë në ndjekje të autorëve të krimit, por deri në këtë moment ka gjetur vetëm një makinë të djegur në periferi të Tiranës. "Shqiptarja.com" mëson se Santiago Malko rezulton të jetë mik i ngushtë dhe me Ervis Martinaj, biznesmenin e lojërave të fatit. Malko njihet në kartotekën kriminale të policisë si kontigjent kriminal, dhe i përfshirë në disa ngjarje me armë në Tiranë. Përfshirja e fundit e tij në ngjarje, ka qenë në masakrën e **4 tetorit 2018**, ku mbeti i plagosur Ervis Martinaj, Elio Hato dhe i vrarë Fabian Gaxha.



**[Sh]**  
**LEXO EDHE:**  
**"Ndal policia!" ... Pa maskë, por me hashash në xhep**

Në atë periudhë, Santiago Malko, u shpall në kërkim policor por pas qetësimit të situatës, Malko është vetëdorëzuar në polici ku dhe ka shpjeguar pozicionin e tij në këtë ngjarje. Në pamjet filmike që ka transmetuar Report Tv për këtë ngjarje Malko shfaqet me një kapele, teksa hyn në lokalin ku ndodhi përplasja. Ndërkohë ngjarja tjetër ku ai është përfshirë në këtë veprimtari kriminale ka ndodhur në prill të 2016 për një borxh me dy vëllezërit Edmond dhe Gentian Lashi.

*"Autorët dyshohet se janë larguar në drejtim të fshatit Ferraj, ku dhe kanë djegur mjetin e tyre, tip "Mercedes Benz". Shërbime të shumta policore kanë ngritur disa pika kontrolli në kryeqytet dhe janë vënë në ndjekje të autorëve", njofton policia.*



Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com

**Ora 23:53**

**Identifikohet një nga autorët e dyshuar, ish-polici u qëllua me 10 plumba**



Gazetarja e Report Tv, raporton se një person i identifikuar si D.A është shpallur në kërkim nga policia, si i dyshuari kryesor i vrasjes së ish-policit, Santiago Malko. Dyshohet për motive hakmarrje, e ndërsa mësohet se mbi të autorët kanë qëlluar me 10 plumba, duke e lënë të vdekur në vend.

Share 282

**Ora 23:40**

**Nëna e ish-policit të vrarë shpërthen në britma e lot pak metra larg trupit të pajetë të djalit të saj**

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com



## Report TV -Nëna e ish-policit të vrarë shpërthen në britma e lot



Familjarët e ish-policit që mbeti i vrarë mbrëmjen e sotme në zonën e Xhamllikut në kryeqytet kanë shkuar në vendngjarje. Nëna e viktimës bashkë me disa të afërm të tjerë janë konfliktuar me policinë për shkak se nuk janë lejuar paraprakisht të kalojnë brenda zonës së shiritit të sigurisë. Ajo ka shpërthyer në lot dhe është ulur në një bordurë anës rrugës, pak metra pranë automjetit ku ende qëndronte i vdekur djali i saj.

Share 1.8K

**Ora 23:21****Policia: Gjendet një makinë e djegur në Ferraj, dyshohet se i përket autorëve**

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com





Policia jep informacionin zyrtar mbi vrasjen e ish-policit të 'Xhamlliku'.

*"Sonte rreth ores 22:20 minuta, ne rrugen "Xhanfize Keko", persona ende te paidentifikuar kane qelluar me arme zjarri drejt nje automjeti ne levizje tip "BMW". Per pasoje ka humbur jeten nje i ri, 26-vjeçari S.M.*

*Autoret dyshohet se jane larguar ne drejtim te fshatit Ferraj, ku dhe kane djegur mjetin e tyre, tip "Mercedes Benz". Sherbime te shumta policore kane ngritur disa pika kontrolli ne kryeqytet dhe jane vene ne ndjekje te autoreve.*

*Nderkohe ekspertet e kriminalistikes po mbledhin prova ne vendngjarje, qe do te ndihmojne hetimin. Policia ka nisur te shoqeroje persona qe mund te kene dijeni per rrethanat e krimit.*

*Specialiste nga Sektori per Krimet e Renda ne Drejtorine Vendore te Policise Tirane jane angazhuar si pjese e grupit te posaçem hetimor per zbardhjen e ngjarjes dhe venien para pergjegjesise ligjore te autoreve. Policia e Shtetit fton kedo qe ka dijeni per rrethanat e krimit te telefonoje falas ne numrin 112", njofton policia.*

RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com

re 54



**Ora 23:15****Ish-polici që u vra mbrëmjen e sotme në Tiranë, mik me Ervis Martinaj**

Santiago Malko, ish-polici që u vra sot në zonën e Xhamllikut në kryeqytet njëhej si mik me Ervis Martinaj. Ai ka qenë prezent në ngjarjen e ndodhur **vitin e kaluar** në bllok ku u vra Fabian Gaxhaj. Në mbrëmjen kur ka ndodhur vrasja në Bllok, Malko është fokusuar nga kamerat e sigurisë duke hyrë brenda në lokal, teksa në kokë mbante edhe një kapele. Ai ka hyrë në lokal pas Ervis Martinajt dhe Eljon Hatos në lokalin Monopol.

Share 216

**Ora 23:03****Identifikohet viktimja e atentatit të 'Xhamlliku', kush është ish-polici i vrarë**RAPORTO! Chat live  
me Shqiptarja.com



Identifikohet viktimja e atentatit të 'Xhamlliku'. Ai është Santiago Malko, ish polic. Ai ka qenë i përfshirë në një ngjarje kriminale 3 vite më parë. Në këtë ngjarje janë përfshirë dy vëllezërit Edmond dhe Gentian Lashi, 34 dhe 26 vjeç dhe 23 vjeçari Santiago Malko, ky i fundit ish punonjës i Patrullës së Përgjithshme të Policisë së kryeqytetit.

Ata janë përfshirë në një konflikt të ashpër fizik, në rrugën "Ismail Alla", vetëm disa metra larg Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Konflikti dyshohet të ketë ndodhur për shkak të një borxhi. Të dyja palët, kanë në pronësi lokale bastesh sportive në të njëjtën zonë, por sipas Policisë konflikti ka ndodhur në lokalin e Edmond Lashit. Ka qenë ish-polici Santiago Malko që ka shkuar në pikën e basteve të vëllezërve Lashi dhe është konfrontuar fizikisht me ta. Nga përleshja fizike, 23-vjeçari është plagosur lehtë, pasi është goditur me grusht në hundë. Është raportuar se dy vëllezërit i kishin marrë pistoletën ish-policit dhe kanë tentuar ta vrasin.

Share 174

**Ora 00:37****Tiranë- Ekzekutohet në makinë me 10 plumba ish-polici 26-vjeçar**